



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

K.DH.SH.II.nr.962/2023

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS – Dhomat e Shkallës së Dytë, me gjyqtarin individual Krenar Berisha, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit Ministria e Shëndetësisë - Inspektorati Shëndetësor me seli në Prishtinë, Instituti B, kati përdhese (te rrethi i QKUK-së), kundër debitorit N.B. B.I. – Ordinanca Stomatologjike “Bajra Dent” me seli në Prishtinë, Lagjja Mati 1, rr.“Muharrem Fejza” p.nr, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson XH.S. avokat në Prishtinë, me bazë juridike përmbarimore, duke vendosur lidhur me ankesën e autorizuarit të debitorit, të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.191/2023 të datës 12.06.2023, me datë 04.12.2023, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e debitorit N.B. B.I. – Ordinanca Stomatologjike “Bajra Dent” me seli në Prishtinë, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.191/2023 i datës 12.06.2023, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e ankimuar KPPP.nr.191/2023 të datës 12.06.2023, ka Refuzuar si të pabazuar prapësimin e debitorit të përmbarimit N.B. B.I. – Ordinanca Stomatologjike “Bajra Dent” me seli në Prishtinë, me numër unik identifikues 810143834, të ushtruar kundër urdhrin për lejimin e përmbarimit P.nr.101/2022 datë 02.11.2022 të lejuar nga përmbaruesi privat Arben Gashi me seli të zyrës në Prishtinë dhe urdhrin e përmbaruesit privat P.nr.101/2022 datë 02.11.2022 e ka lënë në fuqi.

Kundër këtij aktvendimi, në afatin ligjor ankesë ka paraqitur i autorizuari i debitorit, për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të aprovohet në tërësi ankesa ashtu që të anulohen aktvendimi i ankimuar KPPP.nr.191/2023 i datës 12.06.2023 dhe urdhri përmbarimor P.nr.101/2022 i datës 02.11.2022.

Përgjigje në ankesë nuk ka paraqitur kreditori.

Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Dytë, përmes gjyqtarit individual, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e ankimuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 194 e 208 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), e lidhur me nenin 3 paragrafi 2 dhe nenin 17 të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore (LPP) dhe gjeti se:

Ankesa e debitorit është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori Ministria e Shëndetësisë - Inspektorati Shëndetësor me seli në Prishtinë, Instituti B, kati përdhese (te rrethi i QKUK-së), me datë 02.11.2022, ka paraqitur propozim për përmbartim kundër debitorit N.B. B.I. – Ordinanca Stomatologjike “Bajra Dent” me seli në Prishtinë, Lagjja Mati 1, rr.“Muharrem Fejza” p.nr., në bazë të dokumentit përmbartues – vendimit të Inspektoratit Shëndetësor nr.10/Aj-139/20 të datës 24.12.2021, për pagesën e gjobës në lartësi 2,000.00 €.

Përmbartuesi privat Arben Gashi, duke vepruar sipas propozimit për përmbartim të kreditorit me urdhrin P.nr.101/2022 të datës 02.11.2022, ka lejuar përmbartimin ndaj debitorit në bazë të dokumentit përmbartues – vendimit administrativ, duke vlerësuar se dokumenti përmbartues i plotëson kushtet për përmbartim. Kundër këtij urdhri përmbartimor i autorizuari i debitorit ka paraqitur prapësim duke kundërshtuar në tërësi urdhrin përmbartimor, me arsyetimin se vendimi i gjobës ka një arsyetim abstrakt dhe të përgjithësuar nga i cili nuk vërtetohet arsyeja e dhënies së gjobës, duke shtuar se nuk qëndrojnë pretendimet e shkeljeve ligjore, sepse nga hetimet e kryera nga Oda e Stomatologëve të Kosovës – respektivisht Këshilli i Etikës së Odës së Stomatologëve të Kosovës (OSK), është vërtetuar se nuk ka pasur shkelje siç ka pretenduar Inspektorati shëndetësor, andaj ka propozuar që të aprovohet në tërësi si i bazuar prapësimi dhe të anulohet urdhri përmbartimor P.nr.101/2022 i datës 02.11.2022.

Kreditore nuk ka parashtuar përgjigje në prapësim

Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, pas vlerësimit të shkresave të lëndës, me aktvendimin e ankimuar KPPP.nr.191/2023 të datës 12.06.2023 ka Refuzuar si të pabazuar prapësimin e debitorit, dhe ka lënë në fuqi urdhrin përmbartimor P.nr.101/2022 të datës 02.11.2022, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktvendimit të ankimuar.

Në arsyetim të aktvendimit të ankimuar Dhoma e shkallës së parë, ka theksuar se pas vlerësimit të propozimit, urdhrin përmbartimor dhe prapësimin e debitorit, ka gjetur se prapësimi i debitorit është i pa bazuar, për faktin se dokumenti përmbartimor, aktvendimi i kreditorit – Inspektorati Shëndetësor, Nr.110/Aj-139/20 datë 24.12.2021, për pagesën e detyrimit, gjobës në lartësi 2,000.00 €, është titull ekzekutiv në kuptim të dispozitave të nenit 21 dhe 22 të LPP-së, pasi që i njëjti është nxjerrë në procedurë të rregullt administrative nga organi përkatës, është i përshtatshëm për ekzekutim dhe përmban vulën e plotfuqishmërisë dhe ekzekutueshmërisë, në të tregohet qartë baza juridike dhe lartësia e detyrimit, si dhe shkaqet se nga buron detyrimi i debitorit ndaj

kreditorit. Tutje gjykata ka arsyetuar se ka shqyrtuar të gjitha pretendimet e palës debitorë, mirëpo të njëjtat ka vlerësuar se nuk mund të merren parasysh në këtë procedurë, pasi që këto pretendime ka qenë dashur që debitori ti adresoj në procedurë administrative sipas këshillës juridike që kreditori i ka dhënë me aktvendimin mbi bazën e të cilit është iniciuar procedura përmbarimore, ashtu siç parashihet me nenin 128 paragrafi 1 të Ligjin për Procedurën e Përgjithshme Administrative. Dhoma e shkallës së parë ka vlerësuar po ashtu edhe vendimin e paraqitur nga debitori në cilësi të provës të Këshillit të Etikës së OSK-së, datë 03.02.2022, organ ky i cili nuk është organ i shkallës së dytë për të vlerësuar kundërshtimet e ngritura me prapësimin e debitorit, andaj gjykata e ka vlerësuar të njëjtin se mund të shqyrtohet në procedurë të konfliktit administrativ dhe jo në procedurë përmbarimore.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Dytë, vlerëson se Dhoma e shkallës së parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përmbarimore, kur ka vendosur sipas prapësimit të debitorit të paraqitur kundër urdhrit të përmbaruesit privat, me të cilin është caktuar përmbarimi i propozuar nga kreditori. Edhe sipas vlerësimit të kësaj gjykate me shikimin në shkresat e lëndës qartë konstatohet se përmbarimi është lejuar në bazë të aktit administrativ i paraparë me nenin 22 paragrafi 1, pika 1.2 të LPP-së, si dokument përmbarues.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së Dytë, Dhoma e shkallës së parë drejtë ka vepruar kur ka konstatuar se dokument përmbarues në rastin konkret paraqet akti administrativ i organit të administratës i nxjerr në pajtim me rregullat në atë procedurë siç parashihet me nenin 24 paragrafi 3 të LPP-së. Së këndejmi, edhe kjo gjykatë është e qëndrimit të njëjtë juridik se në procedurën përmbarimore organi përmbarues, përfshirë këtu edhe gjykatën që ka kompetencë shqyrtimin e ligjshmërisë së përmbarimit, nuk ka tagër të vlerësojë ligjshmërinë e aktit administrativ të nxjerrë në procedurën e brendshme administrative. Andaj, organi përmbarues, përfshirë edhe gjykatën e shkallës së parë shqyrton vetëm rregullsinë dhe përshtatshmërinë e dokumentit përmbarues, me ç'rast procedura sipas prapësimit i nënshtrohet vetëm shqyrtimit rigoroz formal të titullit ekzekutiv. Mirëpo, gjykata nuk ka tagër të vlerësojë ligjshmërinë e procedurës së brendshme administrative të zhvilluar para organit të administratës, përderisa vendimi i tillë përbën akt administrativ i cili cilësohet si dokument përmbarimor.

Fakti se pala në procesin administrativ pretendon shkelje të asaj procedure, respektivisht nëse kreditori i ka zhvilluar apo jo rregullat e procedurës së brendshme administrative, janë objekt shqyrtimi brenda procedurave administrative apo mjeteve të tjera juridike për të vërtetuar ligjshmërinë apo kundërligjshmërinë e aktit administrativ. Ndërkaq, objekt i kësaj procedure është vetëm rregullsia formale e dokumentit përmbarimor, i cili edhe për gjykatën e shkallës së dytë paraqet dokument të përshtatshëm për përmbarim, konform dispozitave të nenit 24 paragrafi 3 dhe 27 të LPP-së.

Bazuar në këto arsye, Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Dytë vlerëson se Dhoma e shkallës së parë në bazë të provave të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës ka marr vendim të drejtë dhe të bazuar në ligj dhe sipas kësaj gjykate aktvendimi i ankimuar nuk është marr me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore.

Në rastin konkret Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Dytë vlerëson se qëndrimi i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe në mënyrë të plotë është vërtetuar gjendja faktike, pasi që akti administrativ përmban vulën e plotfuqishmërisë dhe përmbarueshmërisë, i cili vendim është nxjerr konform autorizimeve ligjore të organit të administratës, ligjshmëria eventuale e të cilit mund t'i nënshtrohet kontrollit të ligjshmërisë në procedurën e konfliktit administrativ.

Kompetenca e Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së Dytë për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual në shkallë të dytë bazohet në dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 209 paragrafi 1, pika b) të LPK-së, lidhur me nenin 17 të LPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhomat e Shkallës së Dytë
K.DH.SH.II.nr.962/2023 me datë 04.12.2023

Gjyqtari,
Krenar Berisha